



**Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Aurora Konstruksion” Shpk.**

**Adresa: Lagjia Nr 1, Pall Metalurgu, hyrja Nr. 1 Kukës.  
Blv Zogu I, Pall pranë fakultetit të Shkencave Tiranë.**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur” **“Rruga për në fshatin Kasallë (degëzimi nga Cekrezi në Cinam) rreth 2 km”.**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: **“Rruga për në fshatin Kasallë (degëzimi nga Cekrezi në Cinam) rreth 2 km”.**

**Fondi limit: 41,663,513** (dyzet e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e trembëdhjetë ) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2016, miratuar me VKB Nr. 58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”, alokuar me VKB Nr. 84, datë 29.12.2016 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 3 (tre) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 12.01.2017, ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 51 datë 27.12.2016.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Bami” shpk**

**NUIS J 94416206 R**

Vlera e ofertës = **28,117,362** (njëzetë e tetë milion e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk & “Aurora Konstruksion”shpk**  
**NUIS K 71412003 A & K 02017003 I**

Vlera e ofertës = **28,666,126** (njëzetë e tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “J.V Bahas” shpk & “Avduli” shpk**

**NUIS J 61827083 D & J 66703306 O**

Vlera e ofertës = **29,040,304** (njëzetë e nëntë milion e dyzetë mijë e treqind e katër) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “Caushi” shpk** **NUIS J 97511807 W**

Vlera e ofertës = **29,179,128** (njëzetë e nëntë milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind njëzetë e tetë) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk** **NUIS K 81716011 V**

Vlera e ofertës = **30,971,163** (tridhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk** **NUIS J 91915001 P**

Vlera e ofertës = **31,219,094** (tridhjetë e një milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Igor Elektrik” shpk & “Fusha” shpk**

**NUIS L61322023P & NUIS J 61922018S**

Vlera e ofertës = **32,893,225** (tridhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

**8. Operatori ekonomik “Hastoci” shpk** **NUIS J 62028009 B**

Vlera e ofertës = **33,351,580** (tridhjetë e tre milion e treqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

**9. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Albin-Tros” shpk & “Rej” shpk**

**NUIS L 13510201 L & NUIS J 93711608 Q**

Vlera e ofertës = **35,355,524** (tridhjetë e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzetë e katër) lekë pa TVSH.

**10. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SMO Union” shpk & “SMO Vataksi” shpk**

**NUIS J 66902042 Q & NUIS L 47022001 J**

Vlera e ofertës = **37,811,918** (tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**11. Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk**

**NUIS K 51712017 A**

Vlera e ofertës = **38,552,452** (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**12. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kola Invest” shpk & “Kupa” shpk**

**NUIS K 93103401 G & NUIS K 51615512 C**

Vlera e ofertës = **38,777,893.20** (tridhjetë e tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë njëzet) lekë pa TVSH.

**13. Operatori ekonomik “Boshnjaku-B” shpk**

**NUIS K 72627402 H**

Vlera e ofertës = **39,258,656** (tridhjetë e nëntë milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**14. Operatori ekonomik “Shpresa-AI” shpk**

**NUIS K 31321021 N**

Vlera e ofertës = **39,549,353** (tridhjetë e nëntë milion e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**15. Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk**

**NUIS K 51501008 J**

Vlera e ofertës = **40,382,118** (dyzet milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**16. Operatori ekonomik “Gjoka Konstruksion” shpk**

**NUIS J 91815014 U**

Vlera e ofertës = **40,790,314** (dyzet milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH.

**17. Operatori ekonomik “Junik” shpk**

**NUIS J 68007522 L**

Vlera e ofertës = **40,914,314** (dyzet milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e treqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH.

**18. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk**

**NUIS K 71401004 W**

Vlera e ofertës = 0 (zero) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:  
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Operatori ekonomik “Bami” shpk**

**NUIS J 94416206 R**

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për Inxhinierin e Mjedisit të deklaruar nga shoqëria “Bami” shpk, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Librezen e punës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Bami” shpk ka paraqitur Dëshmitë e Kualifikimit të lëshuara nga ISHTI për teknikun e ndërtimit dhe manovratorët të cilat janë të paplota, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk ka paraqitur foto për çdo mjet të deklaruar sipas Shtojcës 9, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 13, gërma “d”.
- Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik “Bami” shpk për të vërtetuar se disponon kokore, ka paraqitur Faturën Tatimore me Nr. 549 datë 10.01.2017 sipas të cilës rezulton se disponon 6 kokore. Pra në total shoqëria “Bami” shpk disponon 6 kokore, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 13 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 25 kokore” .

## 2. Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk

**NUIS J 91915001 P**

- Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk, për të vërtetuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1/a dhe pikën 1/b, ka paraqitur keto kontrata pune: 1. “Rikonstruksioni i rruges Voskopoje-Lekas Loti I”, 2. “Rikonstruksion i rruges Agim Qarri”, 3. “Rikonstruksion i rruges Tahir Skenderi”, 4. “Rikonstruksion i rruges Shote Galica”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për punimet e ngjashme, konstatoi se Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim për objektet e sipërcituara, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1, gërma “a”/5.
- Po kështu për të vërtetuar përvojën e suksesshme Shoqëria “Almo Konstruksion” shpk ka paraqitur kontratën me objekt: Veshje asfaltike të rrugëve “Nozllaku”, “17 Nentori”, “5 Dëshmoret”, “Gani Toptani”, “3 Dëshmoret”, me komunën Kashar. Vlera e kontratës është 20.831.757. Shoqërisë “Almo Konstruksion” shpk në bazë të përqindjes së partneritetit (45 %) i takon vlera e realizimit të kontratës në masën 13.531.635 lekë pa TVSH.
- Sa më sipër konkludohet se Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk në lidhje me kontratat e mësipërme të paraqitura për të vërtetuar përvojën e suksesshme nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën 20,831,757 lekë pa TVSH.
- Në këtë mënyrë, operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1, çka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 6.

## 3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Igor Elektrik” shpk & “Fusha” shpk

**NUIS L61322023P & NUIS J 61922018S**

- Operatori ekonomik “Igor Elektrik” shpk, nuk ploteson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapacitetin ekonomik financiar, piken 1 dhe 2, Komisioni i vleresimit te ofertave pasi shqyrtoi dokumentacioni tekniko-ligjore te ketij operatori konstatoi se ky operator ekonomik sipas ekstaktit historik te rregjistrimit tregtar rezultoi i themeluar me date 22.01.2016, në këtë mënyrë ky operator nuk përmbush kriteret: 1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013,2014,2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. 2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013,2014, 2015) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlere mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlere e fondit limit perkatesisht: 41,663,513 (dyzet e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e trembëdhjetë ) lekë pa TVSH. Pra referuar faktit te sipercituar operatori ekonomik “Igor Elektrik” shpk është në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma (a) dhe (b). Ku subjekti per te vertetuar faktin e sipercituar duhet te paraqese: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast vlere e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet;
- Operatori ekonomik “Igor Elektrik” shpk nuk plotëson pikën 5, të Kriterëve e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pasi nuk disponon Inxhinier Mjedisi dhe Inxhinier Topograf.
- Operatori ekonomik “Igor Elektrik” shpk nuk plotëson piken 7 të Kriterëve e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik pasi ne dokumentacionin e paraqitur për manovratorin nuk figuron dëshmia e kualifikimit të lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial.
- Po kështu operatori “Igor Elektrik” shpk nuk ploteson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, piken 5 ku percaktohet se: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, urdher mjeku, diplomë, CV, librezë pune si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, CV, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.) Ky operator nuk ka paraqitur dokumentacion per mjekun e pergjithshem.
- Operatori ekonomik “Fusha” shpk nuk ploteson piken 3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pasi për Drejtuesin Teknik kërkohet të paraqitet dokumentacion: a) Kontratë pune të vlefshme, b) Diplomë, c) CV, d) Librezat e punës. Operatori ekonomik “Fusha” shpk, nuk ka paraqitur asnjë nga dokumnetat e sipercituara, c’ka bie ne kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (b).
- Operatori ekonomik “Fusha” shpk nuk ploteson piken 5 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pasi për Inxhinierin e Ndërtimit, Mjedisit dhe Topograf, ku kërkohet të paraqitet dokumentacion: a) Kontratë pune të vlefshme, b) Diplomë, c) CV, d) Librezat e punës. Operatori ekonomik “Fusha” shpk, nuk ka paraqitur asnjë nga dokumnetat e sipercituara, c’ka bie ne kundërshtim me VKM-në

Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (b).

- Po kështu operatori ekonomik “Fusha” shpk nuk plotëson 7 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik pasi nuk ka paraqitur dëshmitë e kualifikimit të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, për punonjesit manovrator, c’ka bie ne kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (b).

#### **4. Operatori ekonomik “Hastoci” shpk**

**NUIS J 62028009 B**

- Operatori ekonomik “Hastoci” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik shtojca nr 9, Kamion Vetshkarkues minimum 15 ton, 2 (dy) copë. Operatorit ekonomik ka paraqitur mjetet të tipit Kamion Vetshkarkues me targë TR 0940 T, AA 515 EY, TR 1829 P. Për mjetin me targë AA 515 EY nuk është paraqitur dokumentacioni sipas pikës 11, gërma (a) të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik shtojca nr 9. Për mjetin TR 1829 P, nga verifikimi I dokumentacionit teknik rezulton Kamion Vetshkarkues me tonazh 12 ton, nën tonazhin e kërkuar në shtojcën nr 9. **Për rrjedhojë ky operator ekonomik** nuk plotëson dh neni 26, pika 8 gërma (c) të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Albin-Tros” shpk & “Rej” shpk**

**NUIS L 13510201 L & NUIS J 93711608 Q**

- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk ka plotësuar tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, Kapaciteti Teknik, pika 7, pasi për njerin nga manovratorët nuk ka paraqitur dëshmitë e kualifikimit të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial. C’ka bie ne kundërshtim edhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (b).
- Operatori ekonomik “Albin Tros” shpk nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, Kapaciteti Teknik, pika 7, pasi për manovratorët nuk ka paraqitur dëshmitë e kualifikimit të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial. C’ka bie ne kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (b).

#### **6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SMO Union” shpk & “SMO Vataksi” shpk**

**NUIS J 66902042 Q & NUIS L 47022001 J**

- Operatori ekonomik “SMO Vataksi” shpk nuk plotëson tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapacitetin ekonomik financiar, pikën 1 dhe 2, pasi komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjorë të këtij operatori i rezultoi se ky operator ekonomik sipas ekzaktit historik të regjistrit tregtar rezulton i themeluar me datë 22.08.2014, në këtë mënyrë ky operator nuk përmbush kriteret: **I.**


*Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013,2014,2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar; 2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013,2014, 2015) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: 41,663,513 (dyzet e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e trembëdhjetë ) lekë pa TVSH.* Pra referuar faktit të sipercituar operatori ekonomik “SMO Vataksi” shpk është në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma (a) dhe (b). Ku subjekti për të vërtetuar faktin e sipercituar duhet të paraqesë: *a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet;* Pra në rastin konkret operatori i sipercituar nuk ka depozituar elektronikisht Bilancin e vitit 2013 dhe deklarimin e xhiros vjetore të vitit 2013.

- Gjithashtu ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e duhur që të vertetojë që ka të punësuar në stafin e tij teknik Inxhinierin e Mjedisit dhe Inxhinierin Topograf, duke mosplotësuar pikën 5 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik.
- Operatori ekonomik “SMO Vataksi” nuk plotëson pikën 6 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku për mjekun e përgjithshëm nuk ka paraqitur “CV” e tij dhe mjeku nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit.
- Operatori ekonomik “SMO Union” shpk nuk plotëson gërmen (b), pika 4 të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Nentor 2015-Nentor 2016.
- Operatori ekonomik “SMO Union” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka deklaruar si pjesë të stafit të punësuar një mjek të përgjithshëm.
- Operatori ekonomik “SMO Union” shpk, nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit pasi për punonjesin teknik ndertimi dëshmia e kualifikimit e lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial ka perfunduar afati i vlefshërisë me datë 09.12.2016. Ndërsa për punonjesit manovrator ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dëshmitë e kualifikimit e lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, c’ka bërë në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (b).
- Automjeti tip Autobitrumatrice i deklaruar nga operatori ekonomik “SMO Union” shpk në shtojcën nr 9, nuk ka dokumentacion të rregullt ligjor, pasi policës së sigurimit të automjetit i ka perfunduar afati i vlefshërisë me datë 28.12.2016, si dhe Certifikatës së Kontrollit Teknik afati i vlefshërisë i ka perfunduar më datë 29.12.2016.

## 7. Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk

- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk ploteson pikën 7, tek Kriteret e Vecanta te Kulifikimit, Kapaciteti Teknik, pasi dëshmisë së kualifikimit të teknikut të ndërtimit lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial ka perfunduar afati i vlefshmerise me date 16.12.2016.
- Pas shqyrtimit te dokumentacionit tekniko ligjore, komisioni i vlersimit të ofertave verjeti se operatori ekonomik nuk plotëson pikës 1 germa (a) te kapacitetit teknik tek Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pasi asnjera prej punëve të ngjashme të paraqitura nga ky operator nuk e ploteson vlerën e kërkuar për të paktën një punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **20,831,757** (njëzet milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Nga përlllogaritja e punëve të ngjashme rezulton se shumatorja e tyre është 70.988.235 (shtatedhjetë milion e nenteqind e tetëdhjet e tete mije e dyqind e tridhjetë e pese) lek pa TVSH, nderkohe qe në germen (b) te pikes 1 te sipercituar ku thuhet se: Operatori ekonomik duhet te kete pervojte te sukseshme ne realizimin e punëve të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **83,327,026** (tetëdhjetë e tre milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH. Në këtë mënyrë operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 cka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 germa “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 6.

#### 8. Operatori ekonomik “Boshnjaku-B” shpk



- Operatori ekonomik “Boshnjaku-B” shpk nuk ka paraqitur “CV” e mjekut dhe Librezen e punes duke mosplotesuar ne kete menyre Kriteret e Vecanta te Kulifikimit te DST, Kapaciteti Teknik, pika 6, ku thuhet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet te kete pjese te stafit te punesuar nje mjek te pergjithshem e vertetuar kjome kontrate te vlefshme pune, urdher mjeku, diplome, CV, libreze pune si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise per te paktën 3 (tre) muajt e fundit”.
- Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjate verifikimit te dokumentacionit shoqerues per mjetet e deklaruar sipas Shtojces 9 konstatoi se nga mjetet e paraqitura vetem Kamioni me targë AA-984-DA, plotësonë tonazhin e kërkuar kamion vetshkarkues 15 ton minimumi.
- Gjithashtu operatori ekonomik “Boshnjaku-B”, për mjetet Kamione me targa AA-221-BG, Autoboti Ujit me targe AA-365-IB dhe SK-1720-A, Autovinci me targe FR-5529-C dh AA-917-HH, Autobetonierja me targe PE-2091-A; PE-2332-A; PE-2129-A nuk ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik si dhe policën e sigurimit të mjetit, nuk plotëson pikën 11 germa (a) të Krieteve të Vecanta te Kualifikimit.
- Shoqëria “Boshnjaku-B” shpk për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur kontratat me objekt: “Ndertim i rrjetit te kanalizimeve, fshatrat Llakatun dhe Shushice komuna Shushice”, “Ndertim I ujesjellesit lagjia Lugu Dardhes, Baba Rexhep, Bashkia Sarande”, “Ndertim i ujesjellesit Kurjan, komuna Kurjan”, “Rehabilitim i linjes se dergimit te ujesjellesit qendra e banuar Dushk, Komuna Dushk”, “Furnizim me uji qytetit te Roskovecit”, “Ndertim i ujesjellesit fshat Algjinaj, komuna Sheze”, “Shtese kati dhe rikonstruksion i shkolles 9 vjecare Riza Ibraliu, komuna Dushk”, “Rehabilitim



i rrjetit te kanalit ujites te rezervuarit Shishtavec”. Sa më sipër asnjëra nga kontratat e sipërcituara nuk është punë e ngjashme me objektin e këtij prokurimi për rrjedhojë Operatori ekonomik “Boshnjaku-B” nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1/a. Po kështu për të vërtetuar përvojën e suksesshme operatori I sipërcituar ka paraqitur edhe kontraten me objekt: “Ndertim i Trotuareve” me bashkin Roskovec me vlere kontrate 6.669.393 lek pa TVSH, pune kjo e cila nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën 20.831.757 (njëzet milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë)lekë pa TVSH.

- Në këtë mënyrë shoqëria “Boshnjaku-B” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 cka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 6.

## 9. Operatori ekonomik “Shpresa-A1” shpk

**NUIS K 31321021 N**

- Operatori ekonomik “Shpresa-A1” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kriteret e Veçanta për Kualifikim/Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pasi për shlyerjen e taksave vendore për Bashkinë Kruje ka paraqitur vetëm dokument mandat pagesën dhe jo vertetim sic e kërkohet në pikën 3 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim/Kapaciteti ekonomik dhe financiar.
- Operatori ekonomik “Shpresa-A1” shpk për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur kontratat me objekt: 1-“Ndertim rruga Zgjimi + Riparim KUN Kamez 3, Valias”. Vlera e kontrates është 18,326,011 lekë pa TVSH. 2- “Ndertim KUN Rruga Marlin Barleti Bathore 6” me vlerë të kontratës 5.996.577 lekë pa TVSH. Sa më sipër konkludohet se Operatori ekonomik “Shpresa-A1” shpk në lidhje me kontratat e mësipërme të paraqitura për të vërtetuar përvojën e suksesshme nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën 20.831.757 lekë pa TVSH,
- Operatori ekonomik “Shpresa-A1” për punën e ngjashme “Vazhdim Punimesh për ndertimin e bulevardit të Kasharit, rr. Skenderbej”, me vlere të kontrates 25.996.575 lek pa TVSH nuk ka paraqitur Certifikaten e marrjes në dorezim. Në këtë mënyrë operatori ekonomik “Shpresa-A1” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 cka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 6.

## 10. Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk

**NUIS K 51501008 J**

- Komisionit të Vleresimit të Ofertave gjatë verifikimit të dokumentacionit shoqerues të operatorit ekonomik “Sireta 2F” shpk, i rezultoi se Deshmia e kualifikimit e leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial për njerin nga manovratorët e kerkuar është e parinovuar pra afati i vlefshmerise se kesaj deshmie eshte deri me date 20/10/2016, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta për Kualifikim/Kapacitet

Teknike pika 7 si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (b) ku thuhet se operatori ekonomik duhet ta vertetojë me: Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

- Operatorit ekonomik “Sireta 2F” shpk për dy makineri te tipit rrul te deklaruar prej tij ne shtojcen nr 9 per disponueshmerine e makinerive me ane te Kontrates se Qerases me Nr. 2791 Rep, Nr. 1626/2 Kol, dt. 08.12.2016, lidhur ne Tirane ndermjete Shoqerise “Sireta 2F” shpk dhe Shoqerise “Aurora Konstruksion”shpk me objekt qeradhenjen e dy rrulave te tipit Rrul rrugesh vetlevizesh, te tipit DYNAPAC CC20 ROLVER, VP 1980 dhe Rrul CATERPILLARE, VP 2006 NGJYRE PORTOKALLI, ne pronesi te shoqerise “Sireta 2F” shpk ku e cila me vullnetin e saj te lire shpreh se i jep me qera keto dy makineri shoqerise “Aurora Konstruksion”shpk per nje periudhe kohore 3 (tre) vjecare, cka bie ne kundertshtim me Kriteret e Vecanta per Kualifikim/Kapacitet Teknike pika 11 shtojca nr 9 dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 8 gërma (c).
- Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk, drejtuesin teknik te deklaruar në këtë procedure “Rruga për në fshatin Kasallë (degëzimi nga Cekrezi në Cinam) rreth 2 km” e ka deklaruar dhe ne proceduren prokuruese “Rikonstruksion i rrugeve te brendshme te fshatit Zall-Herr” ne te cilen eshte shpallur fituese me date 30.12.2016, me autoritetin kontraktorë Bashkia Tirane dhe per te cilen ka deklaruar se nuk do te jete e angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete gjate gjithe kohes ne objekt duke mos plotesuar kështu Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik dhe profesional, pika 3, pjesë përbërëse e Dokumentave Standarte të Tenderit.
- Po keshtu referuar VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, Kreu VIII, Neni 26, pika 8 germa (c) ku citohet se: dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose, sa me siper rezulton se Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk duhet te kete nje numer mesatar prej 45 (dyzete e pese) punonjës per realizimin e kontrates me sukses. Ndërkohë shoqëria është shpallur fituese prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane, per procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugeve te brendshme te fshatit Zall-Herr” me date 30.12.2016, ku numri i punonjesve te kerkuar ka qënë 20 punonjes. Nga verifikimi qe ju be vertetimit te leshuar nga administrat tatimore ne lidhje me specifikimin e numrit te punonjesve vihet re nje diference punonjesish me ata të angazhuar për realizimin e objektit të kontratës, shoqërisë i ngelen vetëm 38 punonjës. Numri mesatar i punonjesve te kerkuar për realizimin e objektit “Rikonstruksion Rruga për në fshatin Kasallë ( degëzimi nga Cekrezi në Cinam ) rreth 2 km”, është 80 punonjes. Në këtë mënyrë shoqeria nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 3, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) ku përcaktohet se:
- Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....
- b)Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....

## 11. Operatori ekonomik “Gjoka Konstruksion” shpk

NUIS J 91815014 U

- Operatori ekonomik “Gjoka Konstruksion” shpk nuk ka plotësuar pikën 7 të Kriterëve të Vecanta të Kulifikimit, tek Kapaciteti Teknik, ku thuhet se: *Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij punonjës me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, kontratë pune të vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë punonjësit me kualifikime si më poshtë:*
  - 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
  - 2 (dy) punonjës manovratorSa me sipër operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë se ka pjesë të stafit të tij një punonjës teknik-ndërtimi, po kështu për 2 (dy) punonjës manovrator nuk ka paraqitur dëshmitë e kualifikimi të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial.
- Nga verifikimi i bërë shtojcës Nr. 9 të deklaramentit mbi disponueshmërinë e mjeteve rezultoi se ky operator ekonomik ka deklaruar dy mjete të tipit kamion Mercedes-Benz me targë AA-601 MD dhe TR 9358 T, mjeti me targë AA-601 MD nuk plotëson tonazhin e kërkuar minimumi 15 ton, për rrjedhojë nuk plotëson pikën 11 të Kriterëve të Vecanta të Kulifikimit, tek Kapaciteti Teknik.

## 12. Operatori ekonomik “Junik” shpk

NUIS J 68007522 L

- Operatori ekonomik “Junik” shpk nuk ka paraqitur Vërtetim Debit për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.* Fakti i mosparaqitjes së Vërtetimit të Debit në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit të publikuar më datë 21.12.2016 dhe zhvilluar më datë 12.01.2017. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “Junik” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bërë në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezultoi se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

- Operatori ekonomik “Junik” shpk nuk ka plotësuar pika 4 gërma “b” të Kritereve të Vecanta të Kulifikimit Kapaciteti Teknik. Pasi nuk ka paraqitur formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore
- Operatori ekonomik “Junik” shpk gjithashtu nuk plotëson pikën 6 të Kritereve të Vecanta të Kulifikimit, Kapaciteti Teknik, pasi nuk ka paraqitur “CV” e mjekut, si dhe mjeku i deklaruar prej këtij operatori ekonomik nuk figuron në listpagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit.
- Po kështu operatori ekonomik “Junik” shpk nuk ka plotësuar pikën 7 të Kritereve të Vecanta të Kulifikimit tek Kapaciteti Teknik, thuhet se: *Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij punonjës me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, kontratë pune të vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë punonjësit me kualifikime si më poshtë:*
  - 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
  - 2 (dy) punonjës manovrator

Per sa me larte operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontrata të vlefshme pune dhe dëshmi kualifikimi të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial për asnjë nga punonjësit e sipercituar.
- Gjithashtu operatori ekonomik “Junik” shpk në shtojcën Nr 9 të deklaramit të disponueshmërisë së makinerive nuk ka deklaruar këto mjete: 1. Grejder, 2. Autobot Uji, 3. Kamion me Vinc, 4. Makineri Vijezi, 5. Makineri për vendosje guardrail, po kështu edhe kamionet e deklaruar prej tij me targat LE 9298 A, LE 9827 A, AA 278 LR nuk plotësojnë tonazhin e kërkuar minimumi 15 Ton. Për rrjedhojë nuk plotëson pikën 11 të Kritereve të Vecanta të Kulifikimit, Kapaciteti Teknik.

### 13. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk

NUIS K 71401004 W

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike. Ky fakt i konstatuar nga të gjithë anëtarët e KVO-së u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk përveç Ekstraktin të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër duke mos përmbushur asnjë nga Kriteret e Përgjithshme dhe Kriteret e Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Aurora Konstruksion” shpk**, me adresë: **Lagjia Nr 1, Pall Metalurgu, hyrja Nr. 1 Kukës dhe Blv Zogu I, Pall pranë fakultetit të Shkencave Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **28,666,126** (njëzetë e tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, me adresë “Sheshi Skënderbej Nd Nr. 2 Kodi Postar 1001 Tiranë”, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t' i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar , oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **29,040,304** (njëzetë e nëntë milion e dyzetë mijë e treqind e katër) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:** 02.02.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

